



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 359/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga kandidati për deputet Sadri Ferati i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Mitrovicë, paraqitur kundër Vesel Ahmetit – kryesues në V.V, në Mitrovicë për shkak të parregullsive në numërimin e votave, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare në seancën e panelit të mbajtur me 16.06.2014, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa e parashtruar nga Kandidati për deputet Sadri Ferati nga subjekti politik LDK, dega në Mitrovicë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 13.06.2014, nga Sadri Ferati kandidat për deputet të subjektit politik LDK, dega në Mitrovicë, në të cilën pretendohet se në të gjitha e vendvotimet në komunën e Mitrovicës ka marrë 50% të votave, poashtu edhe në vendvotimin me numër 1116b/01R,116b/02R, ndërsa në vendvotimin 1116/03D, në FRK rezultati i ka dalë zero. Parashtruesi i ankesës thekson se anëtarët dhe vëzhguesit e vendvotimit 1116b/03D deklarojnë se në këtë vendvotim kandidati me numër 38 Sadri Ferati ka pas vota, mirëpo gjatë plotësimit të FRK-së votat janë përshkruar gabimisht dhe këto vota i kanë kaluar kandidatit me numër 37, Naim Behluli nga subjekti politik LDK.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultati preliminar nuk është shpallur nga KQZ-ja dhe se mund të ndryshoj në çdo moment, po ashtu Qendra e Numërimit dhe Rezultateve QNR ende është në fazën e procedimit të materialeve zgjedhore nga Qendrat e Votimit. Andaj rezultati zgjedhor nuk ka marrë formën përfundimtare, në momentin e shpalljes së rezultateve përfundimtare të QNR-së palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e sipërsëhënuara dhe në kuptim të Nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hedh poshtë (si të palejuara, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 359/2014 më datën 16.06.2014

Kryesuesi i Panelit

Hasan Shala



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjyka Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.